



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mjetesh për nevojat e Bashkisë Divjakë dhe Agjencisë së Shërbimeve Komunale”, (autobot uji për pastrimin e ujrave të zeza, trajler për transport mbetjesh urbane, autobot uji për larjen e qytetit, makinë me kosh, autoveturë e përdorur, makinë për Policinë Bashkiake dhe makinë teknologjike për mbetjet e re)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34100000-8
Automjete, (CPV): 34111200-0 Vetura, (CPV): 34144511-3 Automjetet për mbledhjen e mbeturinave.

VLERA E FONDIT LIMIT: 36,256,000 (tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa Tvsh, nga të cilat:

-25,474,382 (njëzetë e pesë milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa Tvsh nga Granti, nga të cilat 21,007,715 (njëzetë e një milion e shtatë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh nga Granti për vitin 2025, 3,135,833 (tre milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh nga Granti për vitin 2026 dhe 1,330,834 (një milion e treqind e tridhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë pa Tvsh nga Granti për vitin 2027,

- 10,781,618 (dhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh nga Të ardhurat.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është: 372 927.38 (Treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë pikë tridhjetë e tetë) euro pa Tvsh.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 15.08.2025 është: 97.22

Burimi i financimit: Granti + Të ardhurat e Bashkisë Divjakë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor **Bashkia Divjakë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 9**;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2022, 2023 dhe 2024 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/a dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në piken 2/a citohet: vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e*

prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në reference, është bërë që t'i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2/a dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/a, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet:

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 8 dhe te nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendët që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që

garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës të deklarojë se, mjetet objekt i procedurës së prokurimit, do të jenë të pajisur me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Në çmimin e secilit prej mjeteve objekt i kësaj procedure prokurimi, përfshihen të gjitha shpenzimet për taksat doganore, regjistrimi, siguracioni, targat, kontrolli teknik, taksa, shpenzime materiale për kalimin e pronësisë, etj (sipas rastit), si dhe çdo shpenzim tjetër në funksion të qarkullimit të tyre, siç përcaktohen në Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Kjo deklaratë, shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor, që mallrat objekt prokurimi, të cilët do të dorëzohen pranë AK, do të shoqërohen me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar, standardeve kombëtare e ndërkombëtare, në funksion të qarkullimit të tyre, konform Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës, duhet të deklarojë, se të gjitha mjetet e ofruara, janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuara për çdo mjet, si edhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarde të Tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Vendosja e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklarate, të vërtetojnë dhe garantojnë AK, se të gjitha mjetet e ofruara, janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuara për çdo mjet, si edhe me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentat Standarde të Tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë garancie për mjetet e ofruara, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi gjatë periudhës së garancisë, si dhe periudha e garancisë teknike për secilin mjet, do të jetë si më poshtë:

Garancia e secilit prej mjeteve të reja do të jetë 24 (njëzet e katër) muaj nga data e pranimit

(marrjes në dorëzim përfundimtar pas kolaudimit të të gjithë mjeteve) nga autoriteti

kontraktor, ku përfshihen të gjitha shërbimet periodike dhe për të gjithë llojet e defekteve të shfaqura nga mjeti gjatë kësaj kohe. Mjetet duhet të riparohen brenda 10 (dhjetë) ditë punë në mënyrë që mos të pengojnë mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punëve të bashkisë sonë.

Garancia e secilit prej mjeteve të përdorura do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e pranimit (marrjes në dorëzim përfundimtar pas kolaudimit të të gjithë mjeteve) nga autoriteti kontraktor, ku përfshihen të gjitha shërbimet periodike dhe për të gjithë llojet e defekteve të shfaqura nga mjeti gjatë kësaj kohe. Mjetet duhet të riparohen brenda 10 (dhjetë) ditë punë në mënyrë që mos të pengojnë mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punëve të bashkisë sonë.

Afati i testimit të mjeteve me kapacitetin e tyre të plotë të punës, do të bëhet në një periudhë kohore prej 10 (dhjetë) ditë pune. Nëse gjatë kësaj periudhe testimi, mjetet shfaqin avari, këto mjete do ti kthehen mbrapsht operatorit ekonomik duke kërkuar zëvendësimin e mjetit dhe jo riparimin e tij.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Vendosja e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklarate, të garantojnë Autoritetin Kontraktor, se secili prej mjeteve të ofruara, do të ketë garancinë teknike të kërkuar dhe do të riparohen brenda afatit të kërkuar në mënyrë që mos të pengojnë mirëfunksionim dhe mbarëvajtjen e punëve të AK.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën e cilësisë **SSH/EN/ISO 9001- 2015 ose ekuivalente** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë); e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijë objektin e prokurimit.

(Certifikata si më sipër duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Ne rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë certifikatën **SSH/EN/ISO**, pasi duhet t’i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratës së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura*

ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, si edhe në Ligjin nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se, certifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të krijojë sigurinë, që operatorët ekonomikë ofertues, i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të realizuar me sukses kontratën. Në lidhje me kërkesën që operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin certifikatën e standartit si SSH/EN/ISO, është menduar se, ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i SSH/EN/ISO -s rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, operatorët ekonomikë pjsëmarrës duhet ta paraqesin atë. Paisja me këtë certifikatë SSH/EN/ISO, garanton AK që OE konkurues, plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1-Autobot uji për pastrimin e ujërave të zeza duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

-Kilometra të përshkuara:

Max 150.000km

Mjeti me kilometrazh deri 150,000 km kanë më pak konsum dhe më pak shpenzime riparimi. Motori dhe pjesët kryesore janë ende në gjendje të mirë pune. Një mjet me kilometrazh të ulët ka rrezik më të ulët për prishje të papritura dhe kërkon më pak zëvendësime pjesësh.

-Fuqia e motorit:

Minimumi 230kw

Kërkohet minimumi fuqia minimumi 230 kw për arsyen se mjetet në këtë fuqi kanë rendiment më të lartë për punën e kërkuar.

-Lënda djegëse:

Naftë

Motorët me naftë janë 20% më efikas sesa motorat me benzinë, gjë që ndikon drejtëpërdrejtë në konsumin e mjetit. Motorët me naftë kanë konsum më të ulët karburanti për fuqi të prodhuar. Motorët me naftë ofrojnë më shumë moment në rrota, gjë që i bën më të përshtatshëm për ngarkesa të rënda dhe terrene të ndryshme. Motorët me naftë janë të njohur për jetëgjatësi më të madhe dhe qëndrueshmëri, një avantazh i rëndësishëm për përdorim intensiv.

-Sistem lëvizje:

4x2

Është kërkuar sistem levizje 4x2 për mjetin pasi mjeti do të levizë në rrugë urbane dhe jo në terrene të thyera. Kjo gjë na sjell edhe kosto më të lirë për mirëmbajtjen se një mjet 4x4, dhe efikasitet më të lartë.

-Numri akseve:

2

Çmim më i lirë për blerje dhe mirëmbajtje në krahasim me mjete me më shumë akse. Taksat rrugore, sigurimet dhe janë më të ulëta. Më i manovrueshëm në rrugët urbane ose të ngushta. Më efikas në karburant krahasuar me kamionët më të mëdhenj.

-Trasmisioni:

Manuale

Mjetet me transmesion manual janë mjete me rezistente dhe kosto më të lirë për mirëmbajtje.

-Peshëmbajtja totale:

Minimumi 16000kg

I përshtatet nevojës së punës që kërkohet dhe strukturës së mjetit duke u bazuar në madhësinë e depozitës (kapaciteti mbajtës)

-Depozita:

7-10 m³

Depozita duhet kapacitet 7-10 m³ pasi një kapacitet më të vogël mjeti do kryhen më shumë rrugë, ndërsa për kapacitet më të madhë do krijonte pengesa në manovrim të përditshëm. Depozita duhet të jetë e pajisur me shkallë dhe nivele që tregojnë sasinë e ujit që ka brënda. Depozita e mjetit duhet të jetë e ndarë në dhoma, për arsyen e sigurisë së mjetit dhe drejtuesit të mjetit për mos batisjen e mjetit në rast përshpejtimi ose ndalimi.

- I pajisur me pompë thithëse dhe shtytëse (aksesore dhe pajisje për përdorim)

Pompa thithëse duhet për thithjen e ujërave të zeza në ambiente të ndryshme, pompa nuk duhet të jetë me lëndë djegëse por të jetë pjesë e montuar e mjetit, e pajisur me zorrë jo më pak se 30 m, jo një trup por i ndarë në segmente prej 5 m me bashkuese çeliku. Pompa shtytëse duhet për shkarkimin e ujërave të zeza në impiantin e ujërave të zeza .

2-Trajler për transport mbetjesh urbane duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

-Viti i prodhimit:

Jo më herët se viti 2012

Për përcaktimin e vitit të prodhimit u bazuam tek buxheti dhe në studimin e tregut.

Mjeti që po kërkohej duhet të jetë një mjet transporti funksional në përputhje me standartet bashkekohore të menaxhimit të mbetjeve që të kryejë sa më mirë funksionet për të cilat ai do të perdoret. Transporti i mbetjeve duhet të bëhet vetëm me mjete që janë të pershtatshme me tipin dhe sasinë e mbetjeve që do të transportohen. Duke marrë parasysh se mjetet pas vitit 2012 përfshijnë teknologji të përmirësuar frenimi, konstrukcion me të fortë dhe rezistencë konsiderojmë se janë me të pershtatshëm për ngarkesa të rënda dhe lëvizje në terrene të ndryshme. Gjithashtu këto mjete kanë kosto më të ulët mirëmbajtje krahasuar me trajleret më të vjetër, për shkak se kanë risk amortizimi më të vogël dhe pjesë këmbimi më të disponueshme në treg. Çdo mjet që qarkullon duhet të jetë i sigurt për përdorim dhe i kollauduar, sipas standarteve të caktuara nga autoritetet kompetente. Për mjete më të vjetra se një periudhë e caktuar, kostot e kollaudit rriten dhe rreziku për mosplotësim të kushteve teknike është më i lartë.

Gjithashtu, kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në pikën 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet:

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

-Fuqia motorike:

Minimumi 300kw

Kërkohej fuqia minimumi 300 kw për arsyen se mjetet në këtë fuqi kanë rendiment më të lartë për punën e kërkuar.

-Kilometrazhi:

Jo më shumë se 400,000 km

Kilometrazhi jo më shumë se 400,000 km për arsye se mjeti nuk është konsumuar, amortizuar shumë. Për arsye se këto lloj mjeteve të rënda zakonisht kalojnë 1 milion km ose më shumë gjatë jetës së tyre. 400,000 km është vetëm një fazë e hershme në ciklin e tyre të përdorimit.

-Lënda djegëse:

Naftë

Motorët me naftë janë 20% më efikas sesa motorët me benzinë, gjë që ndikon drejtpërdrejtë në konsumin e mjetit. Motorët naftë kanë konsum më të ulët karburanti për fuqi të prodhuar. Motorët naftë ofrojnë më shumë moment në rrota, gjë që i bën më të pershtatshëm për ngarkesa të rënda dhe terrene të ndryshme. Motorët me naftë janë të njohur për jetëgjatësi më të madhe dhe qëndrueshmëri, një avantazh i rëndësishëm për përdorim intensiv.

-Trasmisioni:

Automatik

Lehtësi në drejtim, më pak lodhje për shoferin, sidomos në trafikun urban. Shoferi mund të fokusohet më shumë tek trafiku dhe manovrat, jo tek ndërrimi i marshave. Përdorim më i mirë në ambiente me ndalesa dhe nisje të shpeshta. Rrit efikasitetin e përdorimit të kazanit, drejtim i butë dhe i kontrolluar është i rëndësishëm për stabilitet dhe siguri.

-Standarti i emetimit:

Minimumi Euro 5

Euro 5 është një standard evropian i emetimeve i prezantuar në vitin 2009 që përcakton kufij për ndotësit e dëmshëm si monoksidi i karbonit, hidrokarburet, oksidet e azotit dhe lëndët grimcore nga sistemet e shkarkimit të automjeteve. Është një hap drejt reduktimit të ndotjes së ajrit dhe përmirësimit të shëndetit publik.

Ai përcakton kufij specifikë për ndotësit si monoksidi i karbonit (CO), hidrokarburet (HC), oksidet e azotit (NOx) dhe lëndët grimcore (PM).

Euro 5 ndihmon në uljen e ndotjes së ajrit, duke kontribuar në shëndet më të mirë publik dhe një mjedis më të pastër.

Euro 5 përfshin gjithashtu standardet e karburantit, të tilla si përmbajtje më e ulët e squfurit në karburantin naftë.

Euro 5 kërkonte që të gjitha makinat me naftë të kenë filtra grimcash për të përmbushur standardet.

-Pesha e mjetit:

7000-8000kg

I përshtatet strukturës së mjetit ndikon në qëndrueshmërinë, përshtatshmërinë e mjetit në terrene të ndryshme.

-Numri akseve :

2

Me vetëm 2 akse, rrezja e kthesës është më e vogël, duke e bërë më të lehtë për manovrim në zona urbane apo rrugë të ngushta.

-Sistemi i levizjes:

4x2

Peshë më e ulët vetjake. Më pak akse dhe një sistem 4x2 (pra, vetëm një aks i tërhequr) do të thotë se mjeti është më i lehtë. Kjo lejon një kapacitet ngarkesë më të madhe bruto, brënda kufijve ligjorë. Kosto më e ulët operative, më pak goma dhe më pak komponente tërheqëse përkthehet në: më pak mirëmbajtje, më pak konsum karburanti, shpenzime më të ulëta për sigurime dhe taksa. Zakonisht, kamionët 4x2 dhe me 2 akse janë më të lirë se versionet 6x2 ose 6x4.

-E pajisur me sistem hidraulik

Sistemi hidraulik në kokën e trajlerit shërben për të komanduar pajisje shtesë në rimorkio, mbështetëse ose këmbë stabilizimi, pajisje bllokimi ose sigurie në rimorkio etj.

Kazani i trajlerit:

-Gjatësia:

Minimumi 11m

-Gjerësia:

Minimumi 2.5m

-Lartësia:

Minimumi 3.5m

Gjatësia minimale 11m, siguron kapacitet të mjaftueshëm për të akomoduar sasinë e kërkuar të mbetjeve urbane dhe pajisjet e nevojshme për kompresim dhe shkarkim. Është gjithashtu dimension i përshtatshëm për stabilitet gjatë transportit.

Gjerësia minimale 2.5m, është dimension standard i pranueshëm për rrugët publike dhe lejon një volum të mjaftueshëm të brendshëm për depozitimin e mbetjeve, pa tejkaluar kufizimet e lejuara në infrastrukturën rrugore.

Lartësia minimale 3.5m, siguron vend të mjaftueshëm për sistemin e kompresimit dhe hinkën mbushëse. Gjithashtu ndihmon në rritjen e vëllimit të përgjithshëm të ngarkesës.

-Vëllimi: Minimumi 45m³

Ky vëllim është i nevojshëm për të përmbushur nevojat e mbledhjes së mbetjeve urbane në zona me densitet të lartë, duke reduktuar frekuencën e zbrazjes dhe duke përmirësuar efikasitetin operacional.

-Trashësia e mureve: Minimumi 4mm

Trashësia garanton rezistencë strukturore kundër konsumimit nga mbetjet dhe presionit të brendshëm gjatë kompresimit. Siguron jetëgjatësi dhe redukton rrezikun e deformimeve ose çarjeve.

- Trashësia e mbulesës: Minimumi 3mm

Mbulesa përballlet me ngarkesë të vazhdueshme gjatë mbushjes dhe zbrazjes. Trashësia 3mm siguron forcë dhe rezistencë ndaj dëmtimeve mekanike.

-Sistemi i Kompresimit -Shkarkimit: 180-200 Bar

Ky presion është optimal për kompresimin efikas të mbetjeve, duke maksimizuar kapacitetin dhe ulur nevojën për transport të shpeshtë. Gjithashtu siguron shkarkim të shpejtë dhe të plotë.

-Hinka mbushëse: Minimumi 3300x2300 mm

Këto përmasa lejojnë mbushje të shpejtë dhe të lehtë me automjete mbledhëse, pa rrezik mbingarkese ose derdhje. Rrit efikasitetin në procesin e mbushjes.

-Kapaku mbylljes: Valvul mbyllje hidraulike

Mbyllja hidraulike ofron siguri, eliminon rrezikun e rrjedhjeve dhe ndihmon në izolimin e erërave dhe përmbajtjes së mbeturinave.

-Numri akseve: 3

Tre akse përmirësojnë shpërndarjen e peshës, sigurojnë stabilitet dhe kapacitet më të lartë ngarkese, duke respektuar kufizimet rrugore për pesha maksimale.

-Sistemi i frenimit: EBS

EBS (Electronic Braking System) siguron frenim të sigurt dhe të balancuar, redukton distancën e frenimit dhe ofron mbrojtje më të madhe për operatorin dhe mjedisin përreth.

-Këmbët e rimorkios të jenë hidraulike dhe me krik hidraulik që funksionojnë paralelisht

Këmbët mbështetëse hidraulike me krik paralel ofron stabilitet gjatë ngarkimit/zbrazjes dhe lehtësi në manovrim. Funksionimi paralel siguron ngarkesë të baraspeshuar dhe minimizon rrezikun e përkuljes së strukturës.

-Pajisjet të jenë me sistem hidraulik me kontroll elektrik dhe manual

Sistem hidraulik me kontroll elektrik dhe manual. Dyfishimi i mënyrave të kontrollit siguron funksionim të vazhdueshëm edhe në rast të dështimit të njërës prej tyre. Përmirëson sigurinë dhe ofron fleksibilitet për operatorin.

3- Autobot uji për larjen e qytetit duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

-Viti i prodhimit:

Jo më herët se viti 2004

Për përcaktimin e vitit të prodhimit u bazua tek buxheti dhe në studimin e tregut.

Zgjedhja e një autoboti uji për larjen e qytetit, i prodhuar jo më herët se viti 2004, është e nevojshme për të garantuar:

-Sigurinë teknike dhe funksionale të mjetit, sidomos në kushte rrugore jashtë qytetit ku terreni mund të jetë i vështirë.

-Amortizim më të ulët dhe jetëgjatësi më të madhe të komponentëve kryesorë.

-Përputhshmëri me standardet e kolaudit dhe inspektimit teknik të mjeteve, të cilat për mjete më të vjetra janë më të rrepta dhe të kushtueshme.

-Kosto më të ulët mirëmbajtjeje dhe konsum më të ulët karburanti, si rezultat i teknologjive më të avancuara pas këtij viti.

-Teknologjia vitit 2004 e në vazhdim ofron përmirësime në sistemet e frenimit, drejtimit dhe pompimit të ujit, çka rrit efikasitetin në përdorim për qëllime si pastrimi, mbushja rezervuarëve, shuarje zjarri etj.

Reduktimi i kostove të mirëmbajtjes dhe konsumit të karburantit, në krahasim me autobotët më të vjetër, është i rëndësishëm për shërbimet publike që operojnë me buxhet të kufizuar.

Kjo kërkesë bazohet në nevojën për të garantuar funksionim të sigurt në kushte terreni të vështirë, përputhshmëri me normat teknike të kolaudit, dhe sigurimin e një shërbimi efikas, me kosto të ulët mirëmbajtjeje dhe rrezik minimal defektesh gjatë përdorimit intensiv.

Çdo mjet që përdoret në rrugë publike, veçanërisht për transport dhe shërbime teknike, duhet të jetë në gjendje të mirë teknike dhe të kolauduar, për të mos rrezikuar sigurinë rrugore. Kjo e bën joefikas përdorimin e mjeteve më të vjetra se 2004 për punë intensive në zona të largëta.

Gjithashtu, kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në pikën 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet:

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

-Kilometrazhi:

Max 270.000 km

Mjeti me kilometrazh deri 270,000 km kanë më pak konsum dhe më pak shpenzime riparimi.

Motorri dhe pjesët kryesore janë ende në gjendje të mirë pune.

Një mjet me kilometrazh të ulët ka rrezik më të ulët për prishje të papritura dhe kërkon më pak zëvendësime pjesësh.

-Fuqia e motorrit:

Minimumi 200kw

Kërkohet fuqia minimumi 200 kw për arsyen se mjetet në këtë fuqi kanë rendiment më të lartë për punën e kërkuar.

-Lënda djegëse:

Naftë

Motorët me naftë janë 20% më efikas sesa motorat me benzinë, gjë që ndikon drejtëpërdrejtë në konsumin e mjetit. Motorët me naftë kanë konsum më të ulët karburanti për fuqi të prodhuar.

Motorët me naftë ofrojnë më shumë moment në rrota, gjë që i bën më të përshtatshëm për ngarkesa të rënda dhe terrene të ndryshme. Motorët me naftë janë të njohur për jetëgjatësi më të madhe dhe qëndrueshmëri, një avantazh i rëndësishëm për përdorim intensiv.

-Trasmisioni:

Manual

Mjetet me transmesion manual janë mjete me rezistente dhe kosto më të lirë për mirëmbajtje.

-Standarti i emetimit:

Minimumi Euro 4

Euro 4 është një standard evropian për kontrollin e ndotjes nga automjetet, që përcakton kufij maksimalë për emetimet e gazrave ndotës si:

CO (monoksidi i karbonit)

NOx (oksidet e azotit)

PM (grimcat e ngurta)

HC (hidrokarburet)

Përputhshmëria me ligjet dhe rregulloret mjedisore.

-Pesha e mjetit:

Min 15000kg

I përshtatet strukturës së mjetit duke u bazuar në madhësinë e depozitës (kapaciteti mbajtës).

-Numri akseve:

2

Çmim më i lirë për blerje dhe mirëmbajtje në krahasim me kamionët me më shumë akse.

Taksat rrugore, sigurimet janë më të ulëta. Më i manovrueshem në rrugët urbane ose të ngushta.

Më efikas në karburant krahasuar me mjetet më të mëdhenj.

-Sistemi i levizjes:

4x2

Përdoret në mjete për qëndrueshmëri dhe manovrueshmëri më të mirë, në rrugët urbane dhe të ngushta të lagjeve. Siguron ndarje më të mirë të peshës, kontroll në rrugë të rrëshqitshme.

- Vëllimi i çisternës:

Minimumi 12m³

Depozita duhet kapacitet minimumi 12m³ pasi një kapacitet më të vogël mjeti do kryhen me shumë rrugë dhe vonon në procesin e punës.

-Pastrimi nga përpara të jetë me presion dhe të kontrolluar nga gabina

Përpara mjeti duhet të ketë të montuar një tub që përballon presionin e ujit, të jetë çelik i xinguar, tubi duhet të jetë i gjatë për të përshkruar të gjithë gjerësinë e mjetit, hedhjen e ujit duhet ta ketë me kënd nga jashtë në pjesët anësore.

-Aksesore dhe pajisje për përdorim

Në pjesën e pasme duhet të jetë e pajisur me tub çeliku të xinguar me rrjedhje uji në gjendje të lirë pa presion në të gjithë gjerësinë e mjetit. Gjithashtu në të dyja krahët anësore të mjetit duhet të ketë dalje uji me rubineta të përshtatshme për të realizur vaditjen në lulishte dhe hapesira të gjelbërta.

Komandimi i ujit në të gjitha daljet e tijë duhet të jetë në gabinë. Pompa nuk duhet të jetë me lëndë djegëse por të jetë pjesë e montuar e mjetit. Duhet të jetë e pajisur me minimumi 30 metra zorrë të gomuar dhe me pajisje që bën mbledhjen e zorrës në përfundim të punës. Depozita duhet të jetë e pajisur me shkallë dhe nivele që tregojnë sasinë e ujit që ka brenda. Depozita duhet të jetë e pajisur me kapak që mundëson pastrimin dhe mirëmbajtjen e depozitës.

Depozita e mjetit duhet të jetë e ndarë në dhoma, për arsien e sigurisë së mjetit dhe drejtuesit të mjetit për mos batisjen e mjetit në rast përshpejtimi ose ndalimi.

Mjeti duhet të jetë i pajisur edhe me sinjalistikën përkatëse që i shërben personelit për të ushtruar një punë sa më të sigurt në rrugë, si tabela dhe ndriçues.

4-Makinë me kosh duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

-Viti i prodhimit:

Jo më herët se viti 2010

Kamionët prodhuar pas vitit 2010 kanë më shumë gjasa të jenë në përputhje me standardin Euro 5 ose më të lartë. Teknologjitë për reduktimin e ndotjes dhe përmirësimin e efikasitetit janë më të avancuara. Gjendje e mirë teknike dhe më pak konsum. Motorë modernë, sisteme elektronike më të përparuara, dhe pjesë mekanike më të qëndrueshme. Mund të përdoren për një periudhë më të gjatë pa nevojë për riparime të mëdha.

Zgjedhja e një makine me kosh të prodhuar jo më herët se viti 2010, për përdorim në shërbime të ndryshme teknike dhe operacionale, është bere per arsye se ofron:

-Siguri në punë, veçanërisht në lartësi dhe në ambiente të ndërlikuara, ku teknologjia pas 2010 ka përmirësuar shumë sistemet e stabilitetit, frenimit dhe kontrollit hidraulik.

-Përshtatshmëri me rregullat e kolaudimit dhe certifikimit teknik, që janë gjithnjë më të rrepta për mjetet e vjetra.

-Kosto më e ulët mirëmbajtjeje dhe efikasitet më i lartë në përdorim të përditshëm.

-Përputhshmëri me normat e ndotjes , që janë më të ulëta në mjetet më të reja.

-Jetëgjatësi dhe investim më i sigurt, krahasuar me makinat më të vjetra që kanë konsum më të lartë karburanti dhe më shumë probleme teknike.

Gjithashtu çdo mjet që përdoret në rrugë publike për shërbime të ndryshme duhet të jetë i kolauduar dhe në gjendje të mirë teknike, dhe të përmbushë normat për qarkullim, siguri dhe mjedis.

Mjetet e prodhimit të hershëm shpesh nuk përmbushin më kërkesat për: sistemin e frenimit, stabilitetin në lartësi, ndotjen e ajrit, funksionimin e sigurt të sistemit hidraulik.

Gjithashtu kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në pikën 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet:

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

-Kilometrazhi:

Jo më shumë se 300,000km

Kamionët me kilometrazh deri 300,000 km kanë më pak konsum dhe më pak shpenzime riparimi. Motori dhe pjesët kryesore janë ende në gjendje të mirë pune. Një mjet me kilometrazh të ulët ka rrezik më të ulët për prishje të papritura dhe kërkon më pak zëvendësime pjesësh.

-Lënda djegëse:

Naftë

Motorët me naftë janë 20% më efikas sesa motorat me benzinë, gjë që ndikon drejtëpërdrejtë në konsumin e mjetit. Motorët me naftë kanë konsum më të ulët karburanti për fuqi të prodhuar.

Motorët me naftë ofrojnë më shumë moment në rrota, gjë që i bën më të përshtatshëm për ngarkesa të rënda dhe terrene të ndryshme. Motorët me naftë janë të njohur për jetëgjatësi më të madhe dhe qëndrueshmëri, një avantazh i rëndësishëm për përdorim intensiv.

-Fuqia motorrike:

Minimumi 130kw

130 kW është një fuqi e përshtatshme për një kamion me 2 akse, duke siguruar:

Performancë të qëndrueshme. Mjaftueshëm fuqi për përdorim në rrugë me pjerrësi apo terrene të ndryshme. Fuqi të mjaftueshme për të operuar (koshin 10-15 m) pa problem. Lejon lëvizjen me ngarkesa deri në kufirin optimal të kamionit. Mban performancë të mirë edhe në nisje dhe ngjitje.

-Trasmisioni:

Automatik

Lehtësi në drejtim, më pak lodhje për shoferin, sidomos në trafikun urban .

Shoferi mund të fokusohet më shumë tek trafiku dhe manovrat, jo tek ndërrimi i marshave.

Përdorim më i mirë në ambiente me ndalesa dhe nisje të shpeshta. Rrit efikasitetin e përdorimit të

koshit, drejtim i butë dhe i kontrolluar është i rëndësishëm për stabilitet dhe siguri.

-Standarti i emetimit:

Minimumi Euro 5

Euro 5 është një standard evropian i emetimeve që përcakton kufij specifikë për ndotësit si monoksidi i karbonit (CO), hidrokarburet (HC), oksidet e azotit (NOx) dhe lëndët grimcore (PM). Euro 5 ndihmon në uljen e ndotjes së ajrit, duke kontribuar në shëndet më të mirë publik dhe një mjedis më të pastër. Euro 5 përfshin gjithashtu standardet e karburantit, të tilla si përmbajtje më e ulët e squfurit në karburantin naftë.

-Gjatësia e krahut:

10-15 m

Kamioni me krah 10-15 m është ideal për punët të cilat ai do përdoret (instalimet elektrike, krasitjen e pemëve etj).

-Lartësia e mjetit:

Max 4 m

Lartësia mbi 4 metra mund të shkaktojë aksidente me strukturat rrugore (ura, sinjalistika, kablllo, pemët etj...), veçanërisht në zonat urbane.

-Numri i akseve:

2

Çmim më i lirë për blerje dhe mirëmbajtje në krahasim me kamionët me më shumë akse. Taksat rrugore, sigurimet janë më të ulëta. Më i manovrueshem në rrugët urbane ose të ngushta. Më efikas në karburant krahasuar me mjete më të mëdhenj.

-Sistemi i levizjes:

4x4

Eshte një mjet praktik dhe i fuqishëm për terrene të vështira.

-Pesha e mjetit :

Minimumi 8000 kg

Një mjet me këtë peshë do të jetë më i qëndrueshëm gjatë përdorimit të krahut(koshit) 10-15 m dhe ngritjes së ngarkesave.

-Pesha mbajtëse e koshit:

Minimumi 250 kg

Koshi është pjesa në fund të krahut të vinçit, ku vendoset ngarkesa për t'u ngritur ose për t'u transportuar. Pesha mbajtëse prej minimum 250 kg tregon që koshi duhet të jetë projektuar dhe i fuqizuar për të mbajtur peshën e ngarkesës (në rastin tone, 250 kg ose më shumë).

-E pajisur me ABS & ESP

ABS parandalon bllokimin e rrotave gjatë frenimit: Kjo e ndihmon shoferin të ruajë kontrollin e drejtimit edhe gjatë frenimeve të forta. Rrit sigurinë në rrugë me lagështi, dëborë apo akull: Në këto kushte, rrotat mund të bllokohen lehtësisht pa ABS, por ky sistem e shmang këtë. Redukton gjatësinë e frenimit në shumicën e rasteve, sidomos kur rruga nuk është plotësisht e rrëshqitshme. Mundëson manovrim gjatë frenimit, ndihmon që makina të mund të shmangë një pengesë edhe kur frenohet fort. ESP parandalon rrëshqitjen dhe humbjen e kontrollit në kthesa, ESP aktivizohet automatikisht kur sensori ndjen që makina po humb drejtimin, duke frenuar individualisht rrotat e duhura. Rrit ndjeshëm stabilitetin në kthesa dhe në manovra emergjente. Ndihmon në parandalimin e aksidenteve nga mbiforcimi ose nënforcimi i makinës. Ndihmon veçanërisht në rrugë me lagështi ose në manovra të papritura.

5-Autoveturë e përdorur duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

-Viti i prodhimit:

Jo më herët se viti 2018

Modelet nga viti 2018 ofrojnë efikasitet më të lartë të baterisë, teknologji moderne sigurie, dhe jetë më të gjatë funksionale.

Duke qene se mjeti kërkohet te jete elektrik modelet elektrike te prodhuara nga viti 2018 e ne vazhdim ofrojnë kushte me te mira teknike si:

1. Përmirësim i teknologjisë së baterisë

Nga vitit 2018, është rritur kapaciteti dhe jetëgjatësia e baterive.

Modelet më të reja kanë autonomi më të madhe (jo më pak se 400 km me një karikim).

Teknologjitë si bateri me ftohje aktive, mbrojtje termike, dhe menaxhim më i mirë i energjisë janë standarde nga 2018.

2. Mbështetje për Karikim të Shpejtë

Modelet jo me herët se viti 2018 zakonisht mbështesin karikimin e shpejtë në 30-40 minuta.

3. Përditësime Software & Funksione të Zgjuara

Sistemet e asistencës për shoferin (si ruajtja e korsisë, frenimi emergjent, etj) janë më të avancuara.

4. Standardet e sigurisë më të reja

Ligji Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” promovon përdorimin e mjeteve elektrike dhe me konsum të ulët energjie nga institucionet publike.

Veturat elektrike nga viti 2018 e në vazhdim ofrojnë autonomi më të madhe, sisteme më të avancuara të menaxhimit të energjisë dhe bateri me jetëgjatësi më të lartë, duke kontribuar në efikasitet energjetik.

Autoveturat elektrike të prodhuara nga viti 2018 e në vazhdim janë në përputhje me objektivat kombëtare të dekarbonizimit.

Kërkesa e mësipërme u bazua në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në pikën 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

-Lënda Djegëse :

Elektrike

Automjetet elektrike reduktojnë ndjeshëm ndotjen e ajrit dhe zhurmën, si dhe kanë kosto më të ulëta mirëmbajtjeje.

.

-Kilometra të përshkruara:

Jo më shumë se 70 000Km

Tregon një makinë relativisht të re dhe në gjendje të mirë, jetëgjatësi më të madhe të baterisë dhe pjesëve mekanike, si dhe më pak mirëmbajtje.

-Fuqia:

Jo më pak se 130 Kw

Fuqi e mjaftueshme për lëvizje të sigurt dhe efikase në kushte të ndryshme, veçanërisht në terrene të përziera apo udhëtime të gjata.

-Bateria:

Jo më pak se 45kW

Bateri e mjaftueshme për të mbuluar distanca të mëdha me një karikim, me fleksibilitet të lartë në përdorim ditor.

-Autonomia pas çdo karikimi:

Jo më pak se 400 km

Redukton nevojën për karikim të shpeshtë dhe siguron përdorim pa ndërprerje gjatë gjithë ditës ose në udhëtime të gjata.

-Gjatësia totale e mjetit:

Jo më pak se 4300 mm

Siguron hapësirë të bollshme për pasagjerë dhe ngarkesa, duke rritur komoditetin dhe funksionalitetin.

-Gjërësia totale e mjetit:

Jo më pak se 1800 mm

Përmirëson stabilitetin gjatë drejtimit dhe ofron hapësirë të mjaftueshme në kabinë.

- Lartësia:

Jo më pak se 1650 mm

Ofron pozicion më të mirë për drejtim dhe shikueshmëri më të lartë, si dhe përshtatje më të mirë me rrugët interurbane.

6-Makinë për Policinë Bashkiake duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

-Viti i prodhimit:

Jo më herët se viti 2020

Garanton që makina të jetë e fundit me teknologji moderne. Përfiton nga përmirësimet në bateri, elektronikë, siguri dhe efikasitet.

Makinat e prodhuara nga viti 2020 ofrojnë:

1. Autonomi më e madhe dhe më reale. Modelet nga 2020 e në vazhdim ofrojnë autonomi të lartë, (jo më pak se 400 km me një karikim).

Sistemet e menaxhimit të baterisë janë përmirësuar dhe japin performancë më të qëndrueshme edhe në dimër.

2. Karikim më i shpejtë dhe më inteligjent

Makinat elektrike moderne mbështesin:

Karikim të shpejtë nga 100–250 kW (karikim në 20-30 minuta).

Planifikim inteligjent të karikimit, për të kursyer energji dhe kohë.

3. Teknologji më e avancuar

Modelet e pas-2020 kanë:

Sisteme të avancuara të drejtimit gjysmë-autonom .

4. Siguri më e lartë

Modelet pas vitit 2020 përmbushin standarde më të larta sigurie:

Frenim automatik emergjent, detektim i këmbësorëve dhe biçikletave

5. Eficiencë më e mirë energjetike

Motorët elektrikë janë më eficientë dhe më të fuqishëm.

Konsumi i energjisë është më i ulët për km – më shumë kursim në karikim.

6. Mbështetje më e mirë për infrastrukturë

7. Më miqësore me mjedisin, emetimet neto të karbonit gjatë prodhimit janë ndjeshëm më të ulëta.

Ligji Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” promovon përdorimin e mjeteve me konsum të ulët energjie nga institucionet publike dhe kërkon që pajisjet e blera të jenë në nivelin më të lartë të eficiencës energjetike.

Autoveturat elektrike të prodhuara pas vitit 2020 përfshijnë teknologji më të avancuar dhe janë më efikase në përdorim të energjisë sesa modelet e mëhershme.

Kërkesa e mësipërme u bazua në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në pikën 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “*Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”.

- Lënda Djegëse:

Elektrike

Makina funksionon vetëm me bateri elektrike, pra zero emetime lokale. Shpenzon më pak në karburant (karikim elektrik) krahasuar me automjetet me benzinë/naftë. Karikimi mund të bëhet në shtëpi, në punë apo në stacione publike karikimi.

-Kilometra të përshkruara:

E re 0 Km

Makina nuk është përdorur më parë, dhe vjen me garanci të plotë prodhuesi.

-Fuqia:

Jo më pak se 130 Kw

Fuqia e mjaftueshme për një performancë dinamike, përshpejtim të mirë dhe manovra të lehta. Kjo fuqi është tipike për automjete të mesme në segmentin kompakt ose SUV të vegjël. Një makinë me këtë fuqi është përshtatshme për përdorim urban dhe autostradë.

-Bateria:

Jo më pak se 45kW

Bateri prej 45 kWh e bën makinën të jetë në gjendje të bëjë min 400 km me një karikim, në varësi të stilit të vozitjes dhe kushteve rrugore.

-Autonomia pas çdo karikimi:

Jo më pak se 400 km

Kjo është distanca maksimale që makina mund të përshkojë me një karikim të plotë. Autonomia reale mund të ndryshojë bazuar në kushtet e vozitjes (shpejtësia, temperatura, përdorimi i kondicionerit, terreni). Një makinë me këtë autonomi është ideale për përdorim të përditshëm dhe udhëtime më të gjata pa stres për karikim.

-Gjatësia totale e mjetit:

Jo më pak se 4300 mm

-Gjërësia totale e mjetit:

Jo më pak se 1800 mm

-Lartësia:

Jo më pak se 1650 mm

Makinë me dimensione komode dhe praktike, kjo do të thotë një sedilje komode dhe hapësirë e mjaftueshme për pasagjerë.

7- Makine teknologjike për mbetjet(e re) duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

-Viti i prodhimit:

Jo më herët se viti 2020

Zgjedhja e një makine teknologjike për mbetje, jo më herët se viti 2020, lidhet me përparësitë teknologjike, efikasitetin, sigurinë dhe përshtatshmërinë me standardet aktuale mjedisore dhe ligjore të tilla si:

1. Teknologji më e avancuar dhe efikase

Mjetet pas vitit 2020 janë të pajisura me teknologji më të reja, që ofrojnë:

Konsum më të ulët karburanti

Menaxhim më të mirë të kapacitetit të mbetjeve

2. Standarde mjedisore të përmirësuara

Pas vitit 2020, shumica e makinave teknologjike për mbetje janë në përputhje me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare për ndotjen (Euro 6 e më lart).

Ato prodhojnë më pak emetime CO₂ dhe grimca të dëmshme, duke ndihmuar në mbrojtjen e mjedisit.

3. Siguri më e lartë për përdoruesit dhe qytetarët

Pajisjet më të reja kanë sisteme sigurie më të mira: kamera 360°, sensorë lëvizjeje, frena inteligjente, etj.

Reduktohet rreziku i aksidenteve në zonat urbane.

4. Kanë kosto më të ulët mirëmbajtjeje dhe jetëgjatësi më të madhe.

Janë më të përshtatshme për përdorim intensiv urban/rural.

Mjetet që përdoren për grumbullim dhe transport mbetjesh duhet të jenë të tilla që garantojnë shmangien e ndotjes së mjedisit dhe sigurinë gjatë transportit.

Kjo justifikon nevojën për pajisje moderne, që në mënyrë të besueshme përmbushin këto kushte pra të mos jenë më të vjetra se viti 2020.

Mjetet e transportit të mbetjeve duhet të jenë në gjendje teknike të mirë, të mbyllura hermetikisht dhe të minimizojnë rrezikun e ndotjes.

Këtë e përmbushin më mirë makinat teknologjike jo me herët se viti 2020, për shkak të përmirësimeve në ndërtim dhe sistemet automatike të ngjeshjes, mbylljes dhe dezinfektimit.

Kërkesa e mësipërme u bazua në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në pikën 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

-Kilometra të përshkuara:

E re 0 Km

Është përcaktuar që mallrat objekt prokurimi të jenë të reja, të papërdorura, ku viti i prodhimit të jetë jo më parë se 2020 (që në fakt bëhet fjalë për një periudhë të arsyeshme që përfshin 6(gjashte) vite prodhimi 2020,2021,2022,2023,2024,2025). Kjo është kërkuar që mjetet e kërkuara, të jenë të prodhimit të viteve të fundit, në mbështetje edhe të pikës 8/b të V.K.M. nr. 633 datë 16.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike” në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar dhe direktivave të BE për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis,në varësi të kategorizimit të mjeteve, sipas peshës dhe kohës së përdorimit. Këto mjete bëjnë pjesë në gjeneratën e re në drejtim të ekonomisë së karburantit,sigurisë dhe qëndrueshmërisë teknike, eficiencës dhe efikasitetin në koston e përgjithshme, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit si edhe në rregullimin dhe emëtimin e gazrave në natyrë.

-Fuqia e motorrit:

Minimumi 240 kw

Kerkohet minimumi fuqia 240 kw per arsyen se mjetet ne kete fuqi kane rendiment me te larte per ngarkesen e kerkuar.

-Lënda djegëse:

Naftë

Motorët me naftë janë 20% më efikas sesa motorat me benzinë, gjë që ndikon drejtëpërdrejtë në konsumin e mjetit.Motorët me naftë kanë konsum më të ulët karburanti për fuqi të prodhuar. Motorët me naftë ofrojnë më shumë moment në rrota, gjë që i bën më të përshtatshëm për ngarkesa të rënda dhe terrene të ndryshme. Motorët me naftë janë të njohur për jetëgjatësi më të madhe dhe qëndrueshmëri, një avantazh i rëndësishëm për përdorim intensiv.

-Standarti i emetimit:

Minimumi Euro 6

Standarti i emetimit Euro 6 është një rregullore e vendosur nga Bashkimi Evropian që kufizon sasinë e gazrave ndotës që mund të nxjerrin automjetet me motor me djegie të brendshme. Ky standard u bë i detyrueshëm për të gjitha makinat e reja të regjistruara në BE nga shtatori 2015.

Qëllimi i Euro 6 është të reduktojë ndotjen e ajrit duke ulur ndjeshëm,oksidet e azotit (NOx) – veçanërisht për motorët me naftë.Partikulat (PM) grimcat e imta që janë shumë të dëmshme për shëndetin.Monoksidi i karbonit (CO).Hidrokarburet e pashpërbëra (THC) dhe hidrokarburet metanike (NMHC).

-Sistem levizje:

6x2

-Numri akseve:

3

Një makinë teknologjike me sistem 6x2 dhe 3 akse i referohet një automjeti të specializuar (si kamion teknologjik, për shembull në ndërtim, pastrim rrugësh, transport special etj.).

Një sistem 6x2 me 3 akse për makina teknologjike do të thotë një ngarkesë më e madhe e lejuar, pasi shpërndahet në 3 akse, stabilitet më i mirë, sidomos në punime në rrugë ose terren të butë.

Mirëmbajtje më e lirë, pasi vetëm një aks është i fuqizuar.

-Trasmisioni:

Automatik

Transmisioni automatik në makinë teknologjike ka lehtësi në drejtim dhe operim. Nuk ka nevojë për ndërrim manual të marsheve, shoferi përqëndrohet në drejtimin dhe funksionet teknologjike të mjetit. Shumë e dobishme për makina që përdoren në qytete, rrugë të ngushta, ose zona pune me manovrim të shpeshtë. Komoditet për shoferin, eliminon lodhjen nga përdorimi i pedalit të friksionit dhe ndërrimi manual i marsheve. Transmetimi elektronik optimizon ndërrimin e marsheve për të kursyer karburant. Ulje e konsumit, sidomos kur makina funksionon me ngarkesa të rënda ose në rrugë urbane me shumë ndalesa.

-Pesha mbajtëse e mjetit:

10-15 Ton

-Kapaciteti i kazanit:

Minimumi 12 m³

Pesha mbajtëse e mjetit 10-15 Ton është vendosur për tu përshtatur kapacitetit mbajtës të kazanit, për një volum 12m³ për të minimizuar kostot dhe numrin e shpeshtë të rrugëve të transportit për tek pika e grumbullimit të mbetjeve. Kazani duhet të jetë i pajisur me krahë për koshat metalik dhe me krehër për koshat plastike. Në pjesën e pasme të jetë i pajisur me kamer kontrolli dhe butona që përdoren nga punëtorët që sinjalizojnë përfundim të punës. Në pjesën e pasme të kazanit duhet të jenë edhe vende të posaçme për qëndrimin e punëtorëve gjatë procesit të punës.

-Amortizimi i mjetit:

Të jetë me jastëk ajri

Mjetit me amortizim me jastëk ajri kanë komoditet të lartë në drejtim, absorbim shumë më i mirë i goditjeve dhe dridhjeve nga rruga, sidomos në sipërfaqe të dëmtuara ose me pengesa. Stabilitet më i mirë i ngarkesës, jastëkët e ajrit balancojnë automatikisht peshën, duke ruajtur nivelimin e platformës edhe kur mjeti është e ngarkuar vetëm në njërin anë. I domosdoshëm për automjete teknologjike që mbajnë pesha të rënda. Rregullim automatik i lartësisë, mjeti mund të ngrihet ose ulet sipas nevojës (p.sh, për të kaluar pengesa, për të lehtësuar ngarkim-shkarkimin, ose për të hyrë në ambiente të ulëta). Sistemi zbut dridhjet dhe tronditjet, zgjat jetën e komponentëve teknologjikë, manovrim dhe kontroll më i mirë, mjeti është më i qëndrueshëm në kthesa, frenim dhe ngarkesë, sepse jastëkët me ajër rregullojnë peshën në mënyrë dinamike. Pesha shpërndahet në mënyrë më efikase, gomat konsumohen më ngadalë dhe në mënyrë të barabartë. Redukton goditjen e drejtpërdrejtë në strukturën e automjetit. Adaptim për rrugë dhe terrene të ndryshme

Sistemi i jastëkut të ajrit përshtatet automatikisht me terrenin, ideal për makinat që kalojnë nga asfalt në rrugë fshati, kantiere ndërtimi, ose terren të pabarabartë.

Shënim: Mjetet e përdorura duhet të jetë në gjendje shumë të mirë motorike, xhenerike dhe vizuale në pjesën e brendshme/jashtme dhe duke mos pasur dëmtime sidomos për sa i përket korrozionit, dëmtimet nga agjentët atmosferikë, goditjet etj.

Gjendja Fizike:

-Të mos jete i demtuar jashtë dhe brenda kabinës

-Tubat e presionit të vajit të jenë në gjendje të mirë (të pa gripuara)

-Gomat në gjendje të mirë (jo të konsumuara)

***Shënim: Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.**

***Shënim: Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.**

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistët e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT